



Public Health  
England

**NHS**

# Hepatiti B

Një udhëzues për  
kujdesin tuaj gjatë  
shtatzënisë dhe  
pas lindjes së  
foshnjës tuaj



**i**mmunisation

mënyra më e sigurt për të  
mbrojtur veten dhe foshnjën tuaj



## Çfarë ka në këtë broshurë?

- 4** Rezultati i testit tuaj të depistimit dhe çfarë do të thotë
- 5** Çfarë është hepatiti B?
- 5** Si e mora hepatitin B?
- 6** Planifikimi i kujdesit tuaj
- 7** Monitorimi i trajtimit dhe i kujdesit tuaj
- 8** Kujdesi për foshnjën tuaj
- 9** Programi i vaksinimit të foshnjës tuaj
- 10** Kur ktheheni në shtëpi
- 11** Kush duhet ta dijë?

---

## Rezultati i testit tuaj të depistimit dhe çfarë do të thotë

---



Kohët e fundit ju janë marrë disa mostra gjaku për analizim. Një rezultat ka treguar që ju keni një infeksion të quajtur hepatiti B.

**Kjo fletëpalosje do të shpjegojë se çfarë është hepatiti B dhe çfarë do të thotë për ju, foshnjën dhe familjen tuaj.**

Kjo fletëpalosje përmban informacione për kujdesin që ju nevojitet gjatë shtatzënisë tuaj për t'ju mbajtur të shëndetshme dhe kujdesin e nevojshëm për fëmijën tuaj dhe anëtarët e tjerë të familjes.



Gjatë shtatzënisë për ju do të kujdeset një ekip specialist, i cili do të shpjegojë të gjitha informacionet në këtë fletëpalosje, përfshirë detajet e kujdesit në dispozicion ku jetoni dhe do t'i përgjigjet çdo pyetjeje që ju ose partneri juaj mund të keni.



Ekipi mund të përfshijë një mami ekzaminuese, një infermiere të specializuar, një mjek të specializuar për kujdesin e mëlçisë, një gjinekolog, një farmacist dhe mjekun tuaj të përgjithshëm, një infermiere dhe një vizitore shëndeti.

## Çfarë është hepatiti B?

**Hepatiti B është një infektion i shkaktuar nga një virus. Një virus është një lloj mikrobi që mund të shkaktojë infektion dhe sëmundje.**

Virusi mund të shkaktojë shumë probleme me shëndetin tuaj, përfshirë inflamacionin (ënjtjen) e mëlçisë dhe mund të rezultojë në probleme serioze të mëlçisë, përfshirë shkatërrimin e saj (cirrozën) dhe kancerin. Mëlçia është organi më i madh në trup dhe shumë i rëndësishëm. Bën shumë punë përfshirë:

- pastrimin e gjakut
- prodhimin e vërit për të ndihmuar në tretjen e ushqimit që hani
- ruajtjen e sheqerit nga ushqimi juaj për t'ju dhënë energji

## Si e mora hepatitin B?

**Infeksioni i hepatitit B është më i zakonshëm në disa pjesë të botës. Një infektion është një sëmundje që mund ta kapësh nga dikush tjetër. Mund të përhapet edhe te njerëzit e tjerë.**

Virusi i hepatitit B gjendet në gjakun ose lëngjet e trupit të një personi të infektuar. Lëngjet e trupit janë gjëra të tilla si gjaku, sperma, pështyma dhe lëngjet vagjinale. Nuk përhapet duke u puthur, mbajtur duart, duke përqaftuar, kollitur, teshtirë ose duke ndarë sende dhe enë.

### **Mund të përhapet në këto mënyra:**

- nga nëna te fëmija gjatë shtatzënisë ose lindjes
- gjatë seksit pa prezervativ
- nga ndarja e gjilpërave të infektuara ose pajisjet e drogës
- përmes pajisjeve të pastërlizuara të përdorura pas një tatuazhi, shpimi të trupit ose trajtimi mjekësor apo dentar
- nga sasi të vogla gjaku që gjenden në furça dhëmbësh ose rroje
- brenda familjeve (fëmijë me fëmijë) në vendet ku infeksioni është i zakonshëm

## Planifikimi i kujdesit tuaj

**Është shumë e rëndësishme të kujdeseni për veten dhe të merrni pjesë në të gjitha takimet tuaja.**

Ekipi specialist do të punojë me ju për të planifikuar kujdesin tuaj gjatë gjithë shtatzënisë dhe lindjes.

### Ata do t'ju japin informacione se:

- si ta mbroni fëmijën tuaj me vaksinime (injeksione) gjatë lindjes dhe deri në moshën 12 muajshe
  - testimin e partnerin tuaj, fëmijëve të tjerë ose çdo anëtar tjetër të familjes
- Ju duhet të bëni disa teste më shumë të gjakut për të zbuluar se sa virusi i hepatitit B është në gjakun tuaj. Këto do të na tregojnë nëse keni një infektivitet **më të ulët** ose **infektivitet më të lartë**.

Ne pastaj mund të planifikojmë trajtimin dhe kujdesin më të mirë për ju dhe foshnjën tuaj bazuar në këto rezultate. Nëse niveli i virusit është i lartë, ekipi juaj i specializuar mund t'ju kërkojë që të merrni tableta për të mbajtur më të ulët nivelet e virusit. Ju gjithashtu mund të keni një skanim për të kontrolluar shëndetin e mëlçisë tuaj.

Ne do t'ju shohim afër fundit të shtatzënisë për të diskutuar se çfarë do të ndodhë kur të lind fëmija juaj dhe do t'ju përgjigjemi pyetjeve që mund të keni. Hepatiti B nuk ndikon në mënyrën e lindjes së foshnjës tuaj. Nuk është një arsye më vete që të keni lindje cezariane.

Ju mund ta ushqeni fëmijën me gji në mënyrë të sigurt. Është shumë e rëndësishme të merrni pjesë në të gjitha takimet pasi fëmija të lindë për t'ju mbajtur mirë ju dhe foshnjën tuaj. Ekipi është aty për t'iu përgjigjur pyetjeve që keni juve apo familja juaj.



## Monitorimi i trajtimit dhe kujdesit tuaj

**Shëndeti Publik i Anglisë (SPA) ka një detyrë ligjore të kryejë mbikëqyrje të sëmundjeve infektive të sëmundjeve të njoftueshme, siç është hepatiti B. Kjo do të thotë të mbahet nën vëzhgim virusi dhe sëmundja për të parë nëse ndryshon dhe të kontrollohet vaksina që përdorim a vazhdon të funksionojë apo jo.**

Është e rëndësishme të dini nëse virusi ka kaluar te fëmija juaj, kur dhe si ndodhi kjo. Për ta bërë këtë, ne do të kërkojmë lejen tuaj për të marrë mostra gjaku nga ju dhe foshnja juaj për t'i dërguar për testime të specializuara:

### Të gjitha gratë dhe foshnjat

- një mostër e vogël e gjakut tuaj në fillim të shtatzënisë
- një mostër e vogël gjaku nga fëmija juaj në moshën 12 muajsh
- nëse jeni infektivitet më i lartë, ne gjithashtu na duhen:
  - një mostër e vogël e gjakut tuaj pas lindjes së fëmijës tuaj
  - 3 njolla të vogla gjaku nga thembra e foshnjës tuaj gjatë lindjes\*

Më pas mund të krahasohet me testin e bërë kur fëmija është një vjeç dhe kjo do t'i ndihmojë shkencëtarët të kuptojnë se si po sillet virusi.



#### \*Shënim

Mostra e gjakut të foshnjës tuaj e marrë në lindje është e ndryshme nga testi i "shpimit të thembrës", i marrë kur fëmija juaj është 5 ditësh dhe është shumë e rëndësishme që foshnja juaj të bëjë atë test depistimi.

## Kujdesi për foshnjën tuaj

**Infeksioni i hepatitit B mund të parandalohet nëse siguroheni që fëmija juaj i ka bërë vaksinimet e tyre në kohë.**

Vaksinimet do të zvogëlojnë në masë të madhe mundësinë e infektimit të foshnjës tuaj.

Foshnjat e lindura nga nënat me hepatit B kanë nevojë për mbrojtje shtesë. Injeksione shtesë jepen menjëherë pas lindjes së foshnjës tuaj edhe kur ato janë 4 javësh dhe 12 muajsh.

Nëse keni pasur nivele të larta të virusit gjatë shtatzënisë, foshnja juaj do t'ju duhet gjithashtu një injeksion shtesë e quajtur imunoglobulina e hepatitit B (HBIG) menjëherë pasi të lindin.

Kur fëmija juaj është 8 javësh ata do të fillojnë vaksinimet rutinore të fëmijërisë, të cilat u ofrohen të gjithë fëmijëve. Këto përfshijnë vaksinën e hepatitit B.

### **SHËNIM I RËNDËSISHËM:**

Në dymbëdhjetë muaj, kur fëmija juaj ka kryer të gjitha vaksinimet e tyre, është i nevojshëm një test gjaku për të parë nëse foshnja juaj ka apo nuk ka infeksion të hepatitit B.





# Programi i vaksinimit të foshnjës tuaj

Foshnjës tuaj do t'ju duhen gjithsej 6 vaksina për t'i mbrojtur ata nga hepatiti B. Është shumë e rëndësishme që foshnja juaj t'i marrë të gjitha.

Para se foshnja të jetë një ditë në spital. Disa foshnje kanë nevojë për një injeksion të dytë të imunoglobulinës (HBIG) për mbrojtje shtesë.



1 ditë

## Vaksinimi 2 - hepatiti i vetëm B

Në 4 javë - sigurohuni që e keni regjistruar foshnjën me një mjek të përgjithshëm.



4 javë

## Vaksinimi 3

Në 8 javë me vaksinimin rutinë të fëmijërisë i cili përfshin hepatitin B.



8 javë

## Vaksinimi 4

Në 12 javë me vaksinimin rutinë të fëmijërisë i cili përfshin hepatitin B.



12 javë

## Vaksinimi 5

Në 16 javë me vaksinimin rutinë të fëmijërisë i cili përfshin hepatitin B.



16 javë

## Vaksinimi 6 - hepatiti i vetëm B

Në 12 muaj, foshnja juaj gjithashtu do të duhet të marrë një test gjaku për të parë nëse ka hepatit B. Kjo është shumë e rëndësishme.



12 muaj



**Mos harroni të merrni librin tuaj të kuq për të gjitha takimet ose të kujtoni profesionistët e shëndetit që ta plotësojnë atë në internet.**

## **ktheheni në shtëpi**

### **Regjistroni lindjen e foshnjës tuaj**

Të gjitha lindjet në Angli, Uells dhe Irlandën Veriore duhet të regjistrohen brenda 42 ditëve nga lindja e fëmijës. Nëse jeni e martuar, burri juaj mund ta bëjë këtë vetëm. Do t'ju jepet një certifikatë lindjeje.

### **Regjistroni fëmijën tuaj me mjekun tuaj të përgjithshëm**

Ju dhe foshnja juaj duhet të regjistroheni në një mjek të përgjithshëm për t'u siguruar që ju të merrni të gjithë kujdesin që ju nevojitet.

Regjistroni foshnjën tuaj sapo të lindë, në mënyrë që të mund të regjistroheni për vaksinimin 4-javor të foshnjës. Do të jetë më e lehtë ta bëni këtë nëse keni certifikatën e lindjes. Tregoni mamisë ose vizitores së shëndetit nëse keni ndonjë problem me këtë.

### **Kujdesi në të ardhmen**

Është e rëndësishme të mbani të gjithë takimet e bëra për ju dhe foshnjën tuaj, përfshirë ato të spitalit me ekipin specialist.

Ju dhe foshnja juaj do t'ju duhet një vizitë te mjeku juaj i përgjithshëm kur fëmija itë jetësh javë për të kontrolluar gjithçka është mirë pas lindjes.

# Kush duhet të dijë për ju dhe foshnjën tuaj?

Ne duhet t'u tregojmë të gjithëve të përfshirë në kujdesin për ju dhe foshnjën tuaj se keni hepatit B, në mënyrë që të mundemi:

- të planifikojmë dhe dorëzojmë kujdesin tuaj në mënyrë të sigurt
- të bëjmë të gjitha takimet që ju nevojiten me ekipet e specializuara
- të bëjmë të gjitha takimet për kujdesin e foshnjës tuaj dhe vaksinimet e ardhshme.

## Ne kemi nevojë për lejen tuaj që t'i tregojmë profesionistëve të tjerë për ju që keni hepatit B. Këto përfshijnë:

- Mjeku i përgjithshëm
- Vizitorja juaj e shëndetit
- Shërbimi i Informacionit të Shëndetit të Fëmijëve që regjistrojnë të gjitha vaksinimet e foshnjës tuaj dhe rezultatet nga testet e kontrollit të porsalindur

PHE mbledh informacion për të siguruar që programet e pasqyimit dhe imunizimit janë të sigurta dhe efektive.

**Kuptoni se si Shëndeti Publik i Anglisë dhe Shërbimi Kombëtar i Shëndetit (NHS) e përdorin dhe mbrojnë informacionin tuaj te [www.gov.uk/phe/screening-data](http://www.gov.uk/phe/screening-data)**

# Informacione të mëtejshme

Shërbimi shëndetësor kombëtar  
[www.nhs.uk/conditions/hepatitis](http://www.nhs.uk/conditions/hepatitis)

---

Regjistrimi i lindjes së foshnjës tuaj  
[www.gov.uk/register-birth](http://www.gov.uk/register-birth)

---

Regjistrimi i foshnjës tuaj me një mjek të përgjithshëm  
[www.nhs.uk/using-the-nhs/nhs-services/gps/how-to-register-with-a-gp-practice/](http://www.nhs.uk/using-the-nhs/nhs-services/gps/how-to-register-with-a-gp-practice/)

---

Regjistri shëndetësor personal i fëmijës tuaj (libri i kuq)  
[www.nhs.uk/conditions/pregnancy-and-baby/baby-reviews/#the-personal-child-health-record-red-book](http://www.nhs.uk/conditions/pregnancy-and-baby/baby-reviews/#the-personal-child-health-record-red-book)



© Crown copyright

Mars 2020

Nëse dëshironi të porosisni më shumë kopje falas ose të shkarkoni versione të ndryshme të përkthyer të kësaj fletëpalosjeje, ju lutemi vizitoni: [www.healthpublications.gov.uk/Home.html](http://www.healthpublications.gov.uk/Home.html)

Kodi i produktit: 2019256HB

1p 5K MAR (APS)

---

[www.nhs.uk/vaccinations](http://www.nhs.uk/vaccinations)